

**RAPORT PER AUDITIMIN E FONDEVE TE SHPENZUARA NGA  
PARTIA LEVIZJA PER ZHVILLIM KOMBETAR, NE FUSHATEN E  
ZGJEDHJEVE VENDORE TE DATES 21 QERSHOR 2015**

**DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE**

**TIRANE**

Une, Qani Kajo, Ekspert Kontabel i Regjistruar, me licence profesionale nr.076 date 20.03.2000 dhe Nipt K37810309H, ne baze te kontrates se sherbimit nr.7750 date 05.10.2015, te lidhur me KQZ, me objekt “Auditimi i fondeve te shpenzuara prej Partive Politike qe moren pjese ne fushaten e zgjedhjeve vendore te dates 21.06.2015”, kam nderin t`ju paraqes raportin e auditimit, per Partine Levizja per Zhvillim Kombetar.

Auditimi u krye ne baze te ligjit 8580 date 17.02.2000 “Per partite Politike”, i ndryshuar me ligjin 10374 date 10.02.2011. Gjithashtu auditimi u krye ne baze te ligjit 10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin te profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontablit te Miratuar” si dhe ligjit 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Auditimi kryhet gjithashtu , ne baze te vendimit nr.969 date 10.08.2015 te KQZ-se sipas shortit.

Duke u mbeshtetur ne bazen ligjore te mesiperme, une, auditova fondet e shpenzuara nga Partia per Zhvillim Kombetar me kyetar zotin Dashamir Shehi.

Per kete qellim mora kontakt me kryetarin e Partise, kordinatorin dhe finacierin e kesaj partie, hartuam aneks kontraten per kryerjen e auditimit dhe u krijuan te gjitha kushtet per kete auditim pa asnje pengese.

Kryetari I Partise deklaroi se kishte marre fondet e mratuara nga Buxheti i Shtetit sipas ndarjes se bere. Fonde nga donator subjekte juridike dhe individe, nuk kishin pasur per fushate.

Gjithsej ne llogarite e Partise, ishin hyre nga buxheti i shtetit shuma 889.736 Leke. Partia per fushaten e zgjedhjeve kishte bere shpenzime te ndryshme per qerane

sallave te mbledhjeve me elektoratin, shpenzime per ditën e fushatës, fonde te cilat i kishte shperndare nepermjet kordinatorëve , per komisionerët dhe vezhguesit ne qendrat e votimit, shpenzime per postera te ndryshem per kandidatet ne gare dhe per votuesit e Partise, shpenzime per publicitet ne media dhe shpenzime te vogla per levizjet me autovetura vetem per pjesën e karburantit dhe pritje e percjellje duke bere shpenzime te ndryshme per elektoratin.

Te gjitha shpenzimet e kryera ishin bere me dokumenta te rregullta qe plotesonin kushtet e ligjshmerise tatimore, fatura me TVSH, fatura te biznesit vogel me kase dhe disa shpenzime per pritje e percjellje me kupona tatimore.

Une rekomandova qe te eliminohen perdorimi i ketyre kuponave sepse, sipas ligjit per tatimin mbi te ardhurat, kuponat nuk njihen per shpenzime. Ne rastin e ketij subjekti politik, keto shpenzime nuk perbenin materialitet per te deformuar gjendjen e administrimit.

## **Opinionit**

**Sipas opinionit tim si audit, me perjashtim te vrejtes qe permenda me lart, per perdorimin e kuponave tatimor, Partia per Zhvillim Kombetar, ka zbatuar kerkesat e ligjit 8580 date 17.02.2000 “Per partite Politike”, I ndryshuar me ligjin 10374 date 10.02.2011, per perdorimin e fondeve te perfituara nga buxheti i shtetit dhe ligjin 9228 date 27.04.2004 “per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.**

Une si audit, duke u bazuar ne kerkesat e ligjit per auditimin dhe ne te gjitha ligjet ne fushen e tatimeve dhe te mbajtjes se kontabilitet, gjykoj se Partia per zhvillim Kombetar ka perdorur drejt fondet e dhena nga buxheti per fushaten e zgjedhjeve.

Ky raport auditimi hartohet ne tre kopje si dhe ne format elektronik dhe mund te perdoret per gjithe te interesuarit.

Ekspert Kontabel I Regjistruar

Qani KAJO

**Rruga “Hamid Shijaku” Pall. Protial**

**Nr.kontakti Mob 0692070915**